



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RAPORTI I MONITORIMIT 12-MUJOR I 2021

M I R A T O I

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Lorin YMERI

Gëzim KALLAJXHI

Flavio BARÇI

JANAR 2022
ADISA

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.....	3
	A. Treguesit e performancës ne nivel qëllimi	4
	B. Treguesit e performancës në nivel objektiv	4
III.	Buxheti i miratuar dhe faktik për 12 mujorin e vitit 2021	13

I. Hyrje

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është person juridik publik, i organizuar në formën e agjencisë autonome të krijuar me Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, po Ju paraqesim raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021.

Në realizimin e këtij raporti Ekipi i Menaxhimit të Programit ka bërë monitorimin e vazhdueshëm nëpërmjet procesit të vlerësimit dhe krahasimit të treguesve faktik të performancës me ata të planifikuar. Ky raport në vijim është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte ndjekja e vazhdueshme e arritjes së objektivave të synuar të përcaktuar tashmë në deklaratën e programit “Transformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin duke realizuar ndarjen funksionale dhe integrimin e shërbimeve publike në sportel, zhvillimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve, marrjen e opinionëve të qytetarëve dhe monitorimin e lëvritit të shërbimeve të standardizuara.”

Në përfundim të këtij raporti, informacioni i marrë shërbeu për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit për periudhën në vijim. Ekipi i Menaxhimit të Programit ka kryer monitorimin e objektivave bazuar në treguesit e performancës, në sasi dhe vlerë për produktet, si një proces që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse.

Në vijim të këtij raporti do të gjeni një informacion të hollësishëm, të problematikave, mangësive të vërejtura, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës, realizimin e produkteve krahasuar me planin në terma sasiorë dhe cilësorë shoqëruar me argumentet përkatës, konkluzionet si dhe propozimet konkrete për periudhën në vijim në lidhje me ndryshimet për rishikimin apo jo të politikës së programit apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës.

II. Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën: **“Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike”** ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2021, i ndarë sipas artikujve ekonomikë.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve publike të integruara ndaj publikut në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet sporteleve, të cilat asistojnë qytetarët në përdorimin e platformës E – Albania në Qendrat e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi të lartë.

Për matjen e performancës së programit nga Ekipi i Menaxhimit të Programit janë evidentuar dhe matur treguesit në nivel qëllimi dhe treguesit në nivel objektiv, si me poshtë vijon:

A. Treguesit e performancës në nivel qëllimi

1. Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara;
2. Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike;
3. Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA;

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	Plan	Fakt	% Realizimit
Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara	511	511	100%
Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike	1207 (Q) 70 (V)	1207 (Q) 70 (V)	100%
Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA	79%	99%	125%

B. Treguesit e performancës në nivel objektiv

1. Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara;
2. Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj;
3. Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike;
4. Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike;
5. Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Objektiv	Plan	Fakt	% realizimit
Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	11	10	91%
Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj	14	13	93%
Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike	1300	1200	92 %

Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike	370	362	98 %
Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse. (*)	6'	8'	*N/A

*Koha faktike e matur në sportelet pritëse ADISA nuk i referohet më aplikimit të marrë nga sportelistët por asistimit të qytetarëve në kryerjen e aplikimit online në portalin e-albania. Si pasojë e këtij ndryshimi në procesin e punës nuk mund të aplikohet përqindja e realizimit.

Më poshtë po Ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

- Treguesi A.1 - Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara.

Pas finalizimit të projektit të Bankës Botërore ku u hartua një raport vlerësimi gjithëpërfshirës mbi zbatimin e rekomandimeve të ri-inxhinierimit për një grup prej 70 shërbimesh publike, u vu re që këto rekomandime ishin zbatuar në masën të konsiderueshme. Gjatë periudhës raportuese ADISA ka qenë e angazhuar në ri-inxhinierimin e shërbimeve publike, i cili ka si qëllim zhvillimin e një procedure administrative midis institucioneve të administratës shtetërore, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike dhe Agjencisë për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), me qëllim evidentimin e gjendjes aktuale të ofrimit të shërbimeve publike, dokumentimin e kësaj gjendjeje, si edhe thjeshtimin e procedurës, nëpërmjet eliminimit të hapave dhe dokumenteve të panevojshëm, si edhe kur është e mundur, ofrimin e tyre nëpërmjet mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Thjeshtëzimi dhe optimizimi i procedurave dhe dokumentacionit për shërbimet publike.

Në kuadër të prioritetit të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e shërbimeve publike, thjeshtëzimin, optimizimin e procedurave dhe dokumentacionit si dhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr.158, datë 25.11.2019 prej Janarit 2021 e në vazhdim një numër i konsiderueshëm i shërbimeve publike, 1207 prej tyre tashmë ofrohen online në portalin qeveritar e-Albania.

ADISA për vitin 2021 ka planifikuar asistimin në ri-inxhinierimin e shërbimeve publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në total në procesin e ri-inxhinierimit gjatë vitit 2021 është planifikuar përfshirja e 70 shërbime publike duke e çuar totalin e shërbimeve të ri-inxhinieruara në 511. Ky aktivitet është realizuar plotësisht gjatë vitit 2021 për 3 institucionet që kanë qenë në fokus, të cilët kanë përfunduar procesin e dixhitalizimit të shërbimeve publike.

1. Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU);
2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT).

➤ Verifikimi i proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve publike

Gjatë kësaj periudhe, ADISA ka qenë e angazhuar në popullimin e Platformës së Inventarizimit të Shërbimeve Publike (ISHP). Kjo Platformë është konceptuar si një ndërveprim mes institucionit dhe ADISA për shkëmbim të dhënash mbi shërbimet publike dhe mbledhjen e informacionit mbi afatet ligjore, tarifat, ku mund të aplikohet si dhe informacione të tjera për procedurat BO, të cilat do të përdoren në momentin kur institucionit do t'i nënshtrohen procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Informacioni i mbledhur nga Platforma ISHP do të shërbejë për të ndjekur në vijim procesin e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike dhe standardizimit të shërbimeve publike, duke gjeneruar Kartelat Informative, si dhe Formularët e Aplikimit.

Sa më sipër, e në vijim të bashkëpunimit ndërinstitutional, ADISA është angazhuar në 3 faza, përkatësisht: (i) prezantimi i Platformës tek institucionet publike, (ii) Validimi i listës së shërbimeve dhe (iii) plotësimi i Platformës.

Gjatë periudhës raportuese ka vijuar procesi i bashkëpunimit me AZHBR-në, me të cilin është validuar lista e shërbimeve në bazë të Udhëzimit-së nr. 9, datë 26.02.2021 për Skemat Kombëtare si dhe janë plotësuar rubrikat në platformë për 2 shërbimet e reja që ofron ky institucion. Në vijim të bashkëpunimit me institucionet janë hartuar dhe 31 kartela informative të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe 27 kartelat informative të Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme. Tashmë në Qendrën e Informimit për Shërbimet Publike ADISA ofrohet informacion për 9 shërbimet që ka AZHBR-ja, 31 shërbimeve publike të MIE si dhe 27 shërbimeve publike të MEPJ duke e çuar në total 1200 numrin e shërbimeve publike për të cilat japim informacion në kanale të ndryshme komunikimi.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 ADISA në zbatim të VKM-së Nr.525, 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve” dhe nën udhëheqjen e Ministres së Standardizimit të Shërbimeve Publike Znj. Milva Ekonomi ka qenë e angazhuar në procesin e inventarizimit të standardeve për institucionet shërbim ofruese. Si hap i parë u hartua një formular, i cili kishte për qëllim marrjen e informacionit mbi:

- Gjendjen aktuale të standardeve të shërbimeve
- Mënyrat e hartimit dhe miratimit të standardeve
- Qëllimin e përdorimit të tyre
- SOP
- Sistemet e monitorimit
- Publikimin e tyre
- Përditësimin/përmirësimin e tyre

Formular iu dërguar me e-mail 119 institucioneve ndër të cilët:

- 95 institucione plotësuan formularin
- 7 institucione nuk u kualifikuan (nuk ofrojnë shërbime)
- 17 nuk e kanë plotësuar

Nga analiza e kryer mbi vetë deklarin e 95 institucioneve nëpërmjet plotësimit të formularit u vërejtën:

1. Përsa i takon prezencës së standardeve 86% e institucioneve kanë standarde lidhur me shërbimin dhe 56% deklarojnë të kenë SOP;

2. 67% e institucioneve të anketuara deklarojnë se standardet e tyre janë të miratuara me ligj apo VKM rreth;
3. 69% e institucioneve i shohin standardet si mënyrë për të qenë në përputhje me ligjin, jo për të arritur përdoruesin;
4. Ndërsa përsa i takon pyetjes për monitorimin 30% e institucioneve deklarojnë monitorimin e standardeve nëpërmjet një sistemi të dedikuar performance dhe 70% si pjesë e analizës së punës;
5. 75% e tyre deklarojnë të kenë standarde të publikuara në web;
6. Përsa i përket përditësimit 14% deklarojnë se ndryshojnë standardin pas monitorimit të performancës dhe 80% përmirësojnë bashkëpunimin midis departamenteve pas monitorimit.

Në përfundim të analizës u konstatuan shumë problematika ndër kryesore ishte koncepti i “standardit” të shërbimeve publike NUK është i qartë për pjesën më të madhe të institucioneve.

- Treguesi A.2 - Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike.

Sportelet e Zyrave Rajonale/Vendore ADISA ofrojnë asistencë për rreth 1207 shërbimet publike të pushtetit qendror dhe 70 të tilla të pushtetit vendor që aplikohen nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, për një total prej 1270 shërbimesh.

ADISA gjatë periudhës raportuese ka qenë e angazhuar në hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e administratës publike për përmbushjen e standardeve në ofrimin e shërbimeve. Në këtë kuadër është nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave, ku për shkak të natyrës së shërbimeve që ofron ky institucion, sportelistët e Qendrave të Integruara ADISA janë trajnuar për t’i ardhur në ndihmë biznesit për regjistrimin e markës.

Gjithashtu janë zhvilluar komunikime të vazhdueshme dhe më pas janë hartuar Marrëveshjet e Bashkëpunimit me DPSHTR-në për përfshirjen e tyre në Qendrat e Integruara ADISA Himarë, Malësi Madhe, Kamëz si dhe Zyra Rajonale Tirana 2.

Sipas planifikimit buxhetor afat mesëm (2021 – 2023), për vitin 2021 ishin parashikuar 1207 shërbime qendrore dhe 70 vendore, në total në Qendrat e Integruara ADISA. Ndërkohë që nga Janari 2021 e në vazhdim shumë shërbime kaluan online duke e çuar totalin e shërbimeve në Qendrat e Integruara ADISA në 1207 shërbime qendrore dhe 70 vendore. Bërja e shërbimeve online ndikoi në rritjen e menjëhershme të numrit të shërbimeve të ofruara në Qendrat e Integruara ADISA si dhe tejkaloi parashikimin.

Gjithashtu në sportelet ADISA ofrohen dhe shërbime publike, të cilat nuk ofrohen online nëpërmjet portalit e-albania


- Treguesi A.3- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ADISA

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar matjet e kënaqësisë qytetare pranë Qendrave të Integruara Elbasan (Janar 2021), Tiranë 1 (Shkurt 2021), Librazhd (Mars 2021), Krujë (Prill 2021), Lushnje (Maj 2021), Divjakë (Maj 2021), Tiranë 2 (Qershor 2021), Shkodër (Korrik 2021), Kavajë (Shtator 2021) dhe Fier (Tetor 2021).

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, ish-Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Shqipëri

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Më poshtë paraqitja grafike e realizimit të sondazheve të drejtpërdrejta:



Nga grafiku më lart, vihet re që mesatarja e qytetarëve të kënaqur dhe shumë të kënaqur në Qendrat ku u zhvilluan sondazhet e matjes së kënaqësisë është 99%. Sipas planifikimit buxhetor afatmesëm (2021 – 2023), kënaqësia për vitin 2021 ishte parashikuar në nivelin 79% (kjo duke u nisur nga niveli i kënaqësisë në sportelet e institucioneve përpara hapjes së Qendrave ADISA), fal kushteve me standarde Europiane dhe aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë niveli mesatar i kënaqësisë arriti në 99%.

- Treguesi B.1 – Numri i Qendrave/Njësive të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

ADISA deri tani numëron 10 (dhjetë) Qendra të Integruara të ngritura në rang vendi, përkatësisht në Kamzë, Tiranë, Kavajë, Fier, Krujë, Gjirokastrë, Shkodër, Kombinat, Lushnje dhe Elbasan.

Gjatë vitit 2021 kanë vijuar punimet për zbatimin e planit të shtrirjes në territor të qendrave ADISA në bashkitë Kamëz dhe Vlorë. Në muajin nëntor 2021, ADISA Kamëz ka nisur funksionimin e saj për të ofruar shërbimet e saj në këtë bashki duke asistuar rreth 133,499 qytetarëve (sipas censusit të vitit 2011) të Kamzës dhe zonave përreth, në kushte dhe standarde bashkëkohore.

Çelja dhe funksionimi i zyrës së përbashkët ADISA me bashkinë e Kamzës, do të asistojë qytetarët për 1207 shërbime publike të cilat ofrohen online përmes portalit e-albania dhe shërbime të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), ALEAT, Posta Shqiptare, Ujësjellës Kanalizime

Kamzë, dhe rreth 70 shërbime vendore të bashkisë Kamzë në 25 sportele fizikë. Qytetarët e Kamzës dhe zonave përreth, do të mund të asistohen edhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQeDuam.al.



Përsa i përket godinës së përzgjedhur në bashkinë Vlorë, si pasojë e tërmetit të Nëntorit 2019, projektuesi ka vlerësuar se godina ka amortizim të theksuar dhe për këtë arsye u krye një vlerësim i thelluar i cili përcaktoi formën e punimeve të cilës do të duhet t'i nënshtrohet. Duke qenë se godina e përzgjedhur është në bashkë-përdorim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), pas rezultateve të vlerësimit të thelluar, ASHK do të vijojë me punimet për të kryer përforcimin e godinës sipas projektit të dorëzuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT). Nga ky moment, për ADISA-n është i mundur fillimi i rikonstruksionit të ambienteve të kësaj godine. Gjatë muajit shtator është marrë leja e ndërtimi të projektit të përforcimit nga ASHK.

Përsa i përket godinës së përzgjedhur në bashkinë Durrës, është hartuar draft – marrëveshja e huapërdorjes ndërmjet ADISA-s dhe ASHK-së, e cila ka për qëllim marrjen në përdorim nga ADISA të ambientit për ngritjen e Qendrës së Integruar në këtë qytet. Kjo marrëveshje është ende në fazën e diskutimit ndërmjet palëve.

- **Treguesi B.2 – Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj.**

Përveç qendrave të integruara, ADISA vijon planin e shtrirjes në të gjithë territorin e Shqipërisë edhe nëpërmjet sporteleve të saj në bashkitë jo qendër-qarku. Nëpërmjet ekranit të dyfishtë, në këto sportele asistohen qytetarët në procesin e aplikimit për shërbime publike përmes portalit qeveritar e-albania si dhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQëDuam.al. Vlerë e shtuar për qytetarët e bashkive në të cilat është prezent ADISA nëpërmjet sporteleve të përbashkëta me bashkitë, është ofrimi i shërbimeve vendore dhe qendrore në një vend të vetëm në ambiente bashkëkohore të standardeve Evropiane, me sistem elektronik të menaxhimit të radhës dhe infrastrukturë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

Aktualisht ADISA është e pranishme në 13 (trembëdhjetë) bashki jo qendër qarku: Maliq, Belsh, Patos, Librazhd, Divjakë, Malësi e Madhe, Kukës, Pogradec, Mat, Roskovec, Kolonjë, Tepelenë dhe Himarë.

Në muajin qershor, ADISA ka vënë në funksion zyrën e përbashkët me bashkinë Tepelenë, e cila do t'u shërbejë rreth 8,949 qytetarëve (sipas censusit të vitit 2011) të Tepelenës dhe zonave përreth, në kushte dhe standarde bashkëkohore. Çelja dhe funksionimi i zyrës së përbashkët ADISA me bashkinë e Tepelenës, do të asistojë qytetarët për rreth 1207 shërbime publike, të cilat ofrohen online përmes portalit e-albania, shërbime të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), ALEAT, si dhe shërbime të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në 7 sportele fizikë. Qytetarët e Tepelenës dhe zonave përreth, do të mund të asistohen edhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQëDuam.al. Për më tepër, zyra e përbashkët ADISA me bashkinë Tepelenë, do të ofrojë rreth 70 shërbime vendore të bashkisë në një sportel të dedikuar.



Zyra e përbashkët ADISA me bashkinë Tepelenë, ruan të gjitha standardet europiane për ofrimin e shërbimeve publike duke përmendur këtu, infrastrukturën e përshtatur për PAK dhe informacionin e përshtatur në gjuhën e shenjave, sistemin elektronik të menaxhimit të radhës, ambiente bashkëkohore që do të ofrojnë akses për të gjithë qytetarët në kushtet më të mira të ofruara ndonjëherë në vendin tonë.

Në muajin gusht, ADISA ka vënë në funksion zyrën e përbashkët me Bashkinë Himarë, e cila do t'u shërbejë rreth 7,818 qytetarëve (sipas censusit të vitit 2011) të Himarës dhe zonave përreth, në kushte dhe standarde bashkëkohore. Çelja dhe funksionimi i zyrës së përbashkët ADISA me

bashkinë e Himarës, do të asistojë qytetarët për rreth 1207 shërbime publike të cilat ofrohen online përmes portalit e-albania, si dhe 70 shërbime vendore të bashkisë në 4 sportele fizikë.



Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ADISA ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me bashkitë për të identifikuar vendndodhjet në të cilat do të jetë prezentë në të ardhmen.

- Treguesi B.3 – Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike (Janar – Dhjetor 2021)

Gjatë vitit 2021, ADISA ka hartuar 66 *kartela informative* për 4 *institucione*. Koncretisht për Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Ministria Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) si dhe Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme.

Në total, numri i kartelave të standardizuara nga ADISA është 1200 për 65 institucione publike, nga të cilat 1136 kartela informative janë përpiluar sipas platformës ISHP, 27 kartela në bashkëpunim me MEPJ ndërsa 37 përpara krijimit të kësaj platforme.

Në kuadër të standardizimit të kartelave informative, gjatë vitit 2021, ka vazhduar përditësimi i vazhdueshëm në brendinë e informacionit për rubrikat e shërbimeve publike, referuar automatizimit të shërbimeve, kanalet e lëvrimit dhe përfitimit të shërbimeve, etj. dhe saktësisht për Ministrinë Arsimit dhe Sportit si dhe Qendra Shërbimeve Arsimore.

KARTELA INFORMATIVE TË HARTUARA (JANAR – DHJETOR 2021)		
Nr.	Institucioni	Kartela
1	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)	2
2	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	6
3	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	31
4	Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ)	27
	TOTALI	66

- **Treguesi B.4 – Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike.**

Gjatë kësaj periudhe, ADISA ka hartuar 8 formularë të rinj për 2 institucion. Konkretisht për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV). Numri total i formularëve të aplikimit të standardizuar është 362 për 47 institucione, nga të cilët, 249 formularë të 32 institucioneve janë në përdorim dhe mbulojnë 409 shërbime. Nisur nga objektivi vendosur prej 370 formularësh për vitin 2021, ADISA, ka kapur shifrën e 362 formularëve, një realizim prej 97.8%. Formularët e standardizuar përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, janë si në tabelën më poshtë:

Formularë aplikimi të standardizuar në periudhën Janar – Dhjetor 2021		
Nr.	Institucioni	Formularë
1	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	6
2	Formular ankese Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	1
3	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV)	1
	TOTALI	8

- **Treguesi B.5 – Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse.**

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar matjet e kohës pranë Qendrave të Integruara Elbasan (Janar 2021), Tiranë 1 (Shkurt 2021), Librazhd (Mars 2021), Krujë (Prill 2021), Lushnje (Maj 2021), Divjakë (Maj 2021), Tiranë 2 (Qershor 2021), Shkodër (Korrik 2021), Kavajë (Shtator 2021) dhe Fier (Tetor 2021). Të dhënat e detajuara si në tabelën e mëposhtme:

Qendra e Integruar	Koha e Aplikimit
Tiranë 1	13 min.
Tiranë 2	6 min.
Shkodër	8 min.
Fier	7 min.
Elbasan	8 min.
Krujë	7 min.
Lushnje	10 min.
Kavajë	7 min.
Librazhd	7 min.
Divjakë	8 min.
Koha Mesatare	8 min.

Siç shihet dhe nga të dhënat në tabelë, mesatarja aritmetike e kohëve të aplikimit në Qendrat e Integruara është 8 minuta.

III. Buxheti i miratuar dhe faktik për 12 mujorin e vitit 2021

000/lekë

Buxheti 2021	Plan ¹	Fakt	% realizimit
Paga	122,541	109,584.34	89.43%
Sigurime Shoqërore	18,819	18,245.17	96.95%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	40,152	35,240.71	87.77%
Transferta për Buxh. familjare e individët të paguara nga Instituc. dhe Pushteti Vendor	400	354.32	88.58%
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	67,000	46,226.48	68.99%
Shpenzime Kapitale me financim të huaj	50,000	14,093.89	28.19%

¹ Buxheti Plan pas ndryshimeve të kryera me akt normativ dhe me kërkesë rialokim fondi nga llogaria ekonomike 600 te llogaria ekonomike 602.



Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) është realizuar në përputhje me strukturën, si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për trajtimin me paga të punonjësve. Siç shikohet dhe nga shifrat e vendosura në tabelë, kemi një realizim të kënaqshëm të këtyre dy treguesve, duke mundur plotësimin e plotë të nevojave për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 109,584.3 mijë lekë për artikullin 600 dhe 18,245.2 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në një realizim prej 89.43% dhe

96.95% të zërave respektive ndaj totalit të planifikuar për 12 mujorin. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktik së të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive, si dhe fakti që disa punonjëse janë me leje barrë lindje dhe paguhen nga fondi i sigurimeve shoqërore. Numri faktik i punonjësve të punësuar në fund të muajit Dhjetor 2021 është 181 persona. Brenda këtij numri janë përfshirë edhe 8 punonjëse me leje lindje. Gjatë vitit 2021 janë punësuar si personel me kohë të plotë 55 punonjës. Të larguar nga puna gjatë kësaj periudhe kanë qenë 37 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 35,240.71 mijë lekë ose 87.77% të planit (të ndryshuar) të periudhës. Procedurat për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit vjetor, janë realizuar nga komisioni përkatës në përputhje të plotë me ligjin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shpenzimet janë kryer periodikisht, sipas faturave të dorëzuara. Fondi i realizuar përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje, “Dietat brenda vendit”, “Shpenzime energji elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shërbim postar”, “Shërbim telefoni”, “Shërbim mirëmbajtje automjeti”, “Sigurim automjeti”, “shpenzime për ujësjellës kanalizime”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Rikonstrukcioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Kamëz, ka përfunduar. Është përdorur fondi i miratuar i buxhetit në vlerë 44,471,132 lekë në investimin e bërë në këtë zyrë, fond prej të cilit vlera prej 2,223,557 lekë është mbajtur garanci. Është konkluduar me vënien në zbatim të fondit për shërbimin e Mbikëqyrjes dhe Kolaudit të Rikonstrukcionit të Qendrës së Integruar të Ofrimit të Shërbimeve Publike Kamëz me vlerat respektive 754,947 lekë dhe 74,400 lekë.
2. Kosto Lokale (pagesë për stafin e PMU-së për periudhën Janar – Prill 2021) me vlerë 926 mijë lekë, nga të cilat është realizuar i gjithë fondi.
3. Rikonstrukcion zyresh shërbimi të reja në vlerën 20,763.476 mijë lekë. Ky fond është i padetajuar por i përket Qendrës së Integruar të Shërbimeve Vlorë, për të cilën ka përfunduar procesi i marrjes së lejes së projektit të përforcimit dhe rikonstrukcionit të miratuar për emër të ASHK.

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 50,000 mijë lekë. Ky fond është në kuadër të mbylljes së projektit “Ofrimi i Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin”. Janë procedura të 2020 dhe që paguhen në 4 mujorin e parë të 2021. Nga ky fond janë realizuar në masën 7,161.37 mijë lekë ose 14.32% artikulli 230 dhe artikulli 231 në shumën 6,932.525 mijë lekë ose 13.86%. Në total fondi i investimeve të huaja është realizuar në vlerën 14,093.9 mijë lekë ose 28.19% e fondit plan. Për periudhën Korrik – Dhjetor 2021 nuk ka asnjë investim përse kohë ky fond ishte miratuar vetëm për projektin e mbyllur “Ofrimi i Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin”.

